
Lajmërim i rëndësishëm për tregtinë me Gazin natyror

Të nderuar klientë,

Ju informojmë se Investment Company Limit Prime Securities AD Podgorica për Gazin Natyror do të kalojë nga instrumenti financiar spot në kontrata të së ardhmes që nga data 20 dhjetor 2022. Kjo do të thotë se simboli i vjetër NatGas do të ndërpritet dhe do të hapet një i ri.

Pozicionet e hapura që keni me gaz natyror duhet të mbyllni jo më vonë se data 19.12.2022 ora 22:59, në të kundërt sistemi do t'i mbyllë vetë më pas me çmimin e fundit në dispozicion.

Tregtimi me gazin natyror do të vazhdojë në të njëjtat kushte si deri tani, vetëm me çmime të kontratave të së ardhmes. Të gjitha kushtet e tregtimit janë të disponueshme në platformë dhe do të publikohen në faqen tonë të internetit.